

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rrustem Begolli, me sekretaren juridike Sanije Troshupa, në çështjen penale kundër të pandehurit S.S., nga P., për shkak të veprës penale nga nen 80 i Ligjit nr.03L-163, për Minierat dhe Mineralet lidhur me ninen 49 të Ligjit Nr.04/L-158, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.46/2018, të dt: 11.04.2018, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.46/2018, të dt: 11.04.2018, më **01.06.2018**, jashtë seancës, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.46/2018, të dt: 11.04.2018, dhe gjykata nxjerr këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

#### **Të pandehurit:**

**S.S.:** nga i ati K., eëma A., i lindur me datë ..., në P., me vendbanim në Rr.”Q.”, në P., me numër personal ..., përfaqqsues i autorizuar i N.T.P “I.T.”, me numër të biznesit ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

**S e p s e:** Me datë 15.09.2017, dhe me datë 20.09.2017, gjatë një kontrolli të kryer nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, në zonën Industriale Komuna e Prishtinës, në objektin NTP “I.T.”, i pandehuri me qëllim të pëfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, është hasur duke ushtruar veprimtari ekonomike paautorizim dhe pa leje përkatëse, duke zhvilluar aktivitete për prodhimin e betonit paautorizime ligjore, i cili aktivitet është ndërprerë nga ana i inspektorëve të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale;-

**Me këtë ka kryer veprën penale, nga nen 80 i Ligjit nr.03L-163, për Minierat dhe Mineralet lidhur me ninen 49 të Ligjit Nr.04/L-158, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të neneve 7, 17, 23, 41, 43, 46 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, të pandehurit S.S. i shqipton këtë:

### DËNIM ME GJOBË

I pandehuri: **S.S.** dënohet me gjobë në shumë prej **500.00 € (pesë qind euro)**, të cilën dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënim i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga 1 (një) ditë burgimi për 20 (njëzet) €, të gjobës.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet procedurale për paushallin gjyqësor në shumë prej **20€**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I Dëmtuari: Përfaqësuesi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në P., për realizimin e kërkesës pasuror juridike, udhëzohet në kontest të regult civilo – juridik.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me PP/II.nr.46/2018, të dt: 11.04.2018, ka akuzuar S.S., se ka kryer veprën penale – neni 80 i Ligjit nr.03L-163, për Minierat dhe Mineralet lidhur me nenin 49 të Ligjit Nr.04/L-158, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, dhe njëherësh nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimore, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se të pandehurit kanë kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjyques, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: kallëzimi penal i Komisionit të Pavur për Miniera dhe Minerale me numër protokolli 4366 të datës 04.10.2017, Raporti i Inspektimit të Aktivitetëve të Jashtligjshme Minerar në bazë të dokumenteve të çështjes nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale i datës 20.09.2017, si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata konstaton se i pandehurit S.S., është penalishë përgjegjës për kryerjen e veprës penale nga neni 80 i Ligjit nr.03L-163, për Minierat dhe Mineralet lidhur me nenin 49 të Ligjit Nr.04/L-158, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, ngase veprimet e të njëjtë i përbajnjë elementet e kësaj vepre penale.

Me rastin e shqiptimit të dënitit ndaj të pandehurit, gjykata u ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënitit sipas nenit 74 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM P.nr.1835/2018 të dt.01.06.2018

**Procesmbajtësja,  
Sanje Troshupa**

**G j y q t a r i  
Rrustem Begolli**

**KËSHILLA JURIDIKE:**Të pandehurit ose mbrojtësit e tyre, në afat prej (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi–urdhri ndëshkimore, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.